



**Shoqata e të Verbërve të Kosovës**  
**Kosova Association of the Blind**  
**Udruzenje Slepih Kosova**

# Revista “Syri Ynë”

Botim periodik i Shoqatës së të verbërve të Kosovës

Nr. 22

Prill, 2024



**Funded by  
the European Union**

Ky botim është publikuar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj reviste është përgjegjësi e vetme e *Shoqatës së të verbërve të Kosovës* dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.

**Këshilli botues:**

Enver Ulaj

Melihate Pllana

Bekim Krasniqi

Florian Tishuki

# Përmbajtja

Editorial .....	faqe
Nga aktivitetet e SHVK gjatë muajve mars dhe prill 2024.....	faqe
Hapja e Qendrës Mbështetëse për Studentet me aftësi të kufizuara.....	faqe
Aktivitetet e QBMK në periudhën mars prill 2024.....	faqe
Trajnimet për gjithëpërfshirjen në edukimin fizik.....	faqe
U publikua antologjia e shkrimeve të krijuesve të verbër në Kosovë “Një zemër e mirë”.....	faqe
Vizita e Presidentit të Komitetit paralimpik ndërkombëtar .....	faqe
Historik gjithëpërfshirës i zhvillimit të sporteve te personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.....	faqe
Kronikë lajmesh nga sporti vendor dhe ndërkombëtar.....	faqe

### **Në pritje që “Syri Ynë” të vazhdojë rrugëtimin dhe të ketë vazhdimësi**

Botimi i numrit të radhës së revistës sonë gjatë muaji prill është numri i 22-të i revistës dhe i fundit në këtë format. Më përvojën tonë të krijuar në 12 muajt e kaluar që kemi përgatitur revistën dy mujore, shpresoj që në këtë proces të kemi vazhduar një traditë të mirë dhe të kemi plotësuar sado pak pritjet e lexuesve tanë. Ky numër është numri i fundit që publikohet në kuadër të projektit aktual të mbështetur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian, përmes organizatës Kosovo 2.0. Ndihma e kësaj organizate ka qenë shumë e rëndësishme Shoqatën e të verbër të Kosovës, dhe ne i jemi shumë mirënjohës atyre për zgjatjen e jetës së revistës sonë për një vit, nga prilli i vitit të kaluar deri në prillin e vitit 2024. Në këtë afat kohor kemi publikuar gjashtë numra dymujore të revistës sonë, kemi trajtuar shumë tema, kemi informuar komunitetin dhe kemi mbajtur një komunikimi me anëtarësinë tonë duke i ofruar lajme dhe kronika, intervista dhe tema të trajtuara.

Mungesa e literaturës në shkrimin braj është evidente në Kosovë dhe printimi i një reviste si kjo ka qenë e rëndësishme për ne, pasi na ka krijuar mundësi që t’i ofrojmë komunitetit tonë më shumë informata për gjërat që ndodhin, ndryshimet që presin vetë personat e verbër në Kosovë, administratën dhe legjislacionin dhe në përgjithësi zhvillimet sociale, kulturore e sportive.

Shoqata e të verbërve nuk do ndalet së kërkuar projekte dhe fonde tjera për printimin e kësaj reviste, dhe ne tashmë jemi në angazhimet për të gjetur donatorë tjerë që të na mbështesin më tej për revistën tonë. Një projekt është dërguar drejt Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe presim edhe angazhime tjera deri në sigurimin e financimit për revistën e vetme për të verbër në Kosovë. Falënderojmë shumë organizatën Kosovo 2.0 për mbështetjen e tyre dhe qëllimin e tyre të sinqertë për të kontribuar në diversifikimin e gazetarisë në Kosovë. Stafi i revistës “Syri ynë” dhe Shoqata e të verbërve të Kosovës është në angazhim për të vazhduar më tej me sigurimin e financimit për revistën tuaj.

Shpresojmë të shihemi prapë shumë shpejt, të nderuar lexues.

## Aktivitetet e shoqatës së të verbër të Kosovës në periudhën mars-prill 2024

### **Kuvendi i punës së Shoqatës së të Verbërve të Kosovës.**

Më date 20 prill 2024, në QBMK “Xheladin Deda” në Pejë, Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka mbajtur kuvendin e anëtarëve të saj, ku ka aprovuar raportet e punës së ShVK-së gjatë vitit 2023, dhe ka marrë pëlqimin dhe bashkërendimi për zhvillimin e aktiviteteve të vitit 2024.

Prezent ishin 44 delegatë nga shoqatat komunale dhe ndërkomunale të të verbërve nga e gjithë Kosova.

### **Takim me grupin punues për hartimin e Draft Ligjit gjithëpërfshirës.**

Shoqata e të Verbërve të Kosovës ka qenë pjesëmarrëse në të gjitha takimet që kanë pasur për qëllim draftimin e ligjit gjithëpërfshirës, dhe se fundi në formimin e grupit punues për draftimin e ligjit gjithëpërfshirës nga ana e Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, anëtarë i këtij grupi punues është emëruar edhe kryetari i shoqatës së të verbërve z. Daut Tishuki.

Andaj, nga takimet e mbajtura me këtë grup punës, janë parapa edhe disa takime me personat e verbër apo me përfaqësuesit e tyre dhe në këtë rast Shoqata ka vendos që takime të zhvillohen me anëtarët e Këshillit Drejtues, dhe persona të verbër të shoqatës ku takimi është mbajtur me kryesuesen nga MFTP, znj. Minire Begaj dhe znj. Flaka Bullatovci, ku janë paraqitur me ne detaj nevojat dhe kërkesat e personave të verbër të cilat janë të parapa me ligje ekzistuese por edhe ato të cilat kanë nevojë të theksohen dhe të detajohen përgjegjësit e secilit institucione.

Gjithashtu është theksu se në këtë draft ligje përveç ligjit të verbër që do të shkrihet i plotë do të parashihen edhe plotësim ndryshimi i tij në favor të personave të verbër.

### **Takim dhe vizitë nga përfaqësuesit e NDI**

Vizitë nga zyrtarë të lartë të NDI Uashington, D.C. Mavrice Sayinzoga dhe Cat Ramsey, si dhe nga NDI Kosova ishte Atilla Rexha.

Takimi pati për qëllim diskutimin e sfidave në procesin e digjitalizimit, mundësitë dhe bashkëpunimin me institucionet tona.

Gjithashtu, u theksua potenciali i bashkëpunimit në të ardhmen.

### **Aktivitete për 8 Marsin, Dita e Gruas**

Dita Ndërkombëtare e Gruas, e njohur ndryshe si 8 Marsi, është një ditë që shënon përparimin, solidaritetin dhe arritjet e grave në shumë fusha të jetës. Kjo datë është zgjedhur për të reflektuar mbi të drejtat dhe barazia gjinore. Është një moment për të përshëndetur sukseset e grave në politikë, kulturë,

shkencë, biznes dhe shoqëri në përgjithësi, si dhe për të identifikuar sfidat që ende përballon shoqëria në përmbushjen e barazisë gjinore.

Dita Ndërkombëtare e Gruas ka një histori të gjatë dhe është një kujtesë e rëndësishme për të theksuar nevojën për përkushtim të vazhdueshëm ndaj barazisë dhe drejtësisë gjinore në të gjithë botën.

Andaj, ne në kuadër të projektit të mbështetur nga zyra e Presidencës së Republikës së Kosovës, për nder të kësaj dite ka mbajtur një punëtori me gra dhe vajza duke i identifikuar nevojat, sfidat dhe mënyrat për të avokuar e lobuar për të drejtat e çdo gruaje dhe vajzë që ne i përfaqësojmë.

Kaluam një ditë së bashku, ndamë përvojat tona duke i motivuar të tjerat për tejkalimin e sfidave për të qenë te guximshme në luftë për të drejtën e gruas, sot e çdo ditë.

### **Koordinimi me Shoqatën e të verbërve të Maqedonisë**

Në takim me përfaqësuesit e shoqatës të Maqedonisë së Veriut, është theksuar edhe njëherë bashkëpunimi i mirëfillti në mes të këtyre dy institucioneve. Ky bashkëpunim ka qenë afatgjatë në pjesëmarrje të përbashkëta në takime të ndryshme në rajon dhe me gjerë, nisma për projekte të ndryshme në aplikime për fonde më afatgjate etj.

### **Paraqitja në media**

Revista jonë në muajin e kaluar ka pasur dy prezantime të rëndësishme në media. Një emision në studion të televizorit kosovar T7 dhe një kronikë përgatitur nga zyra e BE-së kanë promovuar revistën dhe kanë prezantuar punën që është bërë gjatë vitit të kaluar.

Në emisioni “Gjesi” të televizionit T7, me qëllim të prezantimit të revistës “Syri ynë” revistë e vetme në shkrimin brail për informim të personave të verbër, në këtë emision pjesëmarrës ishin: Daut Tishuki, Bekim Krasniqi dhe Melihate Pllana

Daut Tishuki, ka prezantuar fillimisht sfidat dhe të arriturat e shoqatës, një histori të jetës së tij për vështirësitë dhe verbërinë, dhe gjithashtu kanë bashkëbiseduar për mundësitë që janë jashtë vendit dhe në Kosovë, pra është bërë një krahasim i mundësive dhe sfidave që kanë personat e verbër në Kosovë, por duke theksuar se në vendin e vet secili ka dëshira të jetoj por vetëm të krijohen kushtet.

Bekim Krasniqi, ka prezantuar gjithashtu programet që ka SHVK, përmes së cilave ofrohen shërbimet për personat e verbër.

Gjithashtu edhe për edukimin dhe shkollimin e personave të verbër, ku kanë pasur sifda dhe mundësi Bekimi ka treguar për edukimin e tij në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim, atëherë shkolla speciale për personat e verbër, ku pastaj ka mbaruar edhe fakultetin Teknologji Informativ në Biznes e sot jep një kontribut të jashtëzakonshëm në shoqatën e të verbërve të Kosovës por edhe në përgjithësi për komunitetin e tij.

Gjithashtu Bekimi ka treguar edhe për njohurit që ka në teknologji asistuese për të verbër dhe ka kërkuar për mbështetje më të madhe në mënyrë që secili persona i verbër të jeton në mënyrë më të mirë të mundshëm sikurse secili qytetar tjetra.

Ndërsa Melihate Pllana, si anëtare e redaksisë Syri ynë, ka folur për shtypjen e revistës, për historinë e saj dhe për rendësin e shtypjes së kësaj reviste.

Historia e revistës syri ynë është shtypur në vitin 201 për herë të parë dhe ka pasur në vazhdimësi donator të ndryshëm dhe tani kemi në shtypje numrin 22 I radhës I cili është shumë pak. Në vitin e fundit, kemi pasur një mbështetje nga organizata Kosova 2.0, e cila përmes një programi Diversifikimi i zërave në gazetari, përmes grantit për media, SHVK ka qenë fituese e këtij granti ku revista syri ynë është pa si një mundësi e kontributit në diversitetin e gazetarisë në Kosovë. Gjithashtu është potencua se revista është mundësuar nga fondet e bashkimit evropian përmes organizatës Kosova 2.0.

Ndërsa kronika e përgatitur nga zyra e BE-së në Prishtinë, ka synuar të prezantojë ambientin e punës dhe mënyrat e përgatitjes së revistës. Në zyrat e Pejës ata janë pritur në ambientet e shoqatës dhe kanë xhiruar dhe prezantuar punën e revistës dhe printimin në braille, si e vetmja revistë në brajl për të verbër në Kosovë. Video është publikuar edhe në rrjetet sociale dhe ka pasur një shikueshmëri të lartë nga publiku.

## **U hap Qendrën Mbështetëse për Studentet me aftësi të kufizuara**

Hapja e Qendrës Mbështetëse për Studentet me aftësi të kufizuara në ditët e fundit ishte një tjetër arritje në krijimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Kjo ishte një arsye për të zhvilluar një bisedë me z. Halil Kurmehaj, këshilltar në zyrën e zëvendëskryeministrit të Kosovës Besnik Bislimi, pasi angazhimi i tij në këtë arritje ishte i dukshëm, sikurse angazhimi edhe në disa iniciativa tjetra lidhur me personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

- Po ju shohim se jeni prezent dhe pjesëmarrës nëpër disa nga nismat dhe iniciativat e reja që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara siç ishte rasti me Qendrën Mbështetëse për Studentet me aftësi të kufizuara në kuadër të UP-së Cilat janë përshtypjet e juaja pas kësaj vizite dhe njëkohësisht fillimin e punës të këtij shërbimi?

Po, me shtysën e fort nga bashkëpunëtorët e mi dhe punën e kësaj Qeverie për ofrimin e mundësive të reja dhe gjithëpërfshirëse, ne arritëm ta kurorëzojmë me sukses së bashku me Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, një shërbim profesional që do t’i ofrojë mbështetje praktike, konkrete të gjithë studenteve me aftësi të kufizuara që janë duke studiuar aktualisht por edhe atyre që planifikojmë të regjistrohen në këtë institucion të dijes.

Ne kemi obligim ti përmirësojmë e rrisim shërbimet profesionale dhe një shembull konkret fillon pikërisht nga Universiteti Publik i Prishtinës. Gjithashtu kjo iniciativë është mbështetur dhe përkrahur nga donatorët sepse është kërkuar investim në pajisje, mobilitet dhe struktura njerëzore. Qeveria e Republikës së Kosovës tashmë po dëshmon se është e përkushtuar për të trajtuar çështjet e personave me aftësi të kufizuara në sfera të ndryshme. Kujdesi dhe mbështetja për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuara është thelbësore për zhvillimin e tyre të suksesshëm dhe përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri, pa asnjë dallim.

- Gjatë fjalimit tuaj përshëndetës theksuat se këto punë për ju janë mision substancial dhe vleror. A mund të na tregoni se si e vlerësoni këtë ditë që tashme u funksionalizua ky shërbim?

Kjo ngjarje shënon një hap të rëndësishëm drejt një arsimit gjithëpërfshirës dhe përfshirje për të gjithë studentët. Në bashkëpunim me partnerët tanë, jemi përkushtuar që ky projekt të jetë një pjesë e përpjekjeve tona për të përmbushur kërkesat dhe nevojat arsimore të studentëve, duke rritur gjithashtu hapësirat e barazisë në ambientet akademike dhe sigurojë shërbime cilësore dhe të domosdoshme. E kam thënë herën e kaluar kur ishte iniciativë, po e ri përsërisë prapë. Qeveria e Republikës së Kosovës është e vendosur të krijojë ambient të përshtatshëm dhe mbështetës për studentët me nevoja të veçanta arsimore. Andaj, Qendra do të jetë burim i rëndësishëm për përmirësimin e shërbimeve arsimore dhe përgatitjen e studentëve për të ardhme të suksesshme. Në një kohë kur po përpiqemi të ndërtojmë një shoqëri më të mirë dhe më të përfshirë në Kosovë, është e rëndësishme që shkollat të ofrojnë mundësi të barabarta për të gjithë. Secili student të ketë mbështetjen e nevojshme për të zhvilluar potencialin e tyre dhe për të kontribuar në të ardhmen e tyre dhe të vendit tonë.



Angazhimi ynë i vazhdueshëm, duke përfshirë ndarjen e pajisjeve teknologjike dhe rritjen e numrit të asistentëve për studentët me nevoja të veçanta arsimore, tregon përkushtimin tonë ndaj kësaj sfide. Bashkëpunimi dhe koordinimi me partnerët tanë janë thelbësore për suksesin e këtij projekti. Gjithëpërfshirja dhe mbështetja e studentëve me nevoja të veçanta nuk është thjesht detyrë programore, por mision substancial dhe vleror.

- Qeveria juaj ka pasur një varg arritjesh në lidhur me personat me aftësi të kufizuara (PAK) si punësimi i asistimeve nëpër shkolla, përgatitja e sintezës vokale në gjuhën shqipe, shpallja e vitit 2022 vit kushtuar personave me aftësi të kufizuara, etj. Mund të na tregoni cilat janë angazhimet e qeverisë në vazhdim lidhur plotësimin standardeve lidhur me personat me aftësi të kufizuara?

Fillimisht duhet theksoj që, një burim inkurajimi për ne është fakti se qeverisja jonë është e përfshirë në këtë komunitet. Së dyti, kemi një inkurajim shtesë për të zhvilluar standarde të reja për këtë komunitet, duke i kushtuar vëmendje të posaçme më të rinjve.

Sinteza vokale në gjuhën shqipe, ashtu siç është theksuar, paraqet një investim të rëndësishëm nga Qeveria Kosovës. Ne, kemi bindjen që, përmes këtij investimi, sidomos nxënësit dhe studentët e verbër do të kenë mundësinë të jenë pjesë aktive e shoqërisë dhe, në të njëjtën kohë, të zhvillojnë potencialet e tyre në mënyrë që të përfshihen plotësisht pa asnjë pengesë në shoqëri. Siç e dini, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përfshirë një nga aktet më të rëndësishme të OKB-së në Kushtetutën tonë. Synimi ynë është të bëjmë amendamentimin e Kushtetutës, duke bërë Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për personat me aftësi të kufizuara pjesë të jetës dhe sistemit juridik dhe institucional të vendit tonë.

- Një nga objektivat e vitit kushtuar personave me aftësi të kufizuara ka qenë punësimi bazuar në ligjin për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e PAK, i cili thotë punësimin e një PAK në çdo 50 persona. Jemi të informuar se kabineti juaj e ka punësuar një person të verbër, por ju personalisht si e shihini gjendjen e punësimit të PAK në Kosovë?

Për ne, punësimi dhe zhvillimi është një nga prioritetet e kësaj qeverie. Punësimi për personat me aftësi të kufizuara nuk është thjesht një detyrim ligjor, siç e keni cekur, por një normë që duhet respektuar, përfshirë këtu edhe ligjin për personat e verbër. Megjithatë, kemi hasur në vështirësi gjatë viteve të kaluara në zbatimin e këtij ligji. Punësimi i të rinjve me aftësi të kufizuara ka një rëndësi të veçantë, pasi synojmë që ata të mos jenë barrë për shtetin, por të shërbejnë si një potencial për shoqërinë. Qeveria, në përpjekje të vazhdueshme për ringjalljen ekonomike, ka ndërmarrë masa aktive për punësimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për këtë komunitet. Kjo nuk ka qenë një përpjekje e izoluar, por është integruar edhe në legjislacionin bazik. Si shembull konkret, mund të përmendim ligjin për zyrtarët publik, ku është normuar me mënyrë taksative punësimi i këtij komuniteti në administratën shtetërore dhe institucionet tjera. Viti që po vjen do të jetë ende më i begatë për të rinjtë tanë, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara në jetën publike. Ndërsa bashkëpunëtori që është emëruar në kabinetin tim, theksoj faktin se ai është i emëruar mbi bazën e profesionalizmit e ekspertizës që ofron, përvojës dhe qasjes pragmatike në trajtimin e çështjeve në kabinetin e Zëvendëskryeministrit. Kësaj here kemi shikuar

aftësitë e jo për shkak të aftësinë e kufizuar apo verbërisë. Besojë te mundësia e barabartë për të gjithë, dhe për mua, ajo është vlerë e çmuar. Ai trajtohet me të njëjtën standard dhe obligohet, sipas ligjit, të kryejë detyrat e tij. Nëse ky person nuk do të ishte emëruar në këtë funksion, do të kishte qenë një person tjetër, pasi për mua, diskriminimi nuk ka vend në jetën time, punën dhe angazhimet e mia politike. Mundësia e barabartë është një pasuri e çmuar.

- Nga muaji janar ka filluar lëvizja e lirë pa viza në zonën Shengen për qytetarët e Kosovës. Cilat janë përgjegjësitë dhe obligimet që kanë qytetarët e Kosovës dhe a keni paraparë se personat me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre mund ta keqpërdorin këtë mundësi për të krijuar kushte më të mira dhe trajnim në vendet e BE-së?

Në përpjekje për të kujdesur për një spektër sa më të gjerë të qytetarëve, jemi përqendruar në organizimin e fushatës sensibilizuese gjithëpërfshirëse dhe të përfshirjes së të gjithëve, pa bërë dallime. Në këtë drejtim, kemi zhvilluar një seri takimesh me shoqatën e personave të verbër, duke krijuar një platformë të hapur ku ata kanë mundësi të shprehin kërkesat dhe nevojat e tyre. Kemi marrë pjesë aktivisht në bisedat dhe diskutimet për të identifikuar mënyrat më efektive të mbështetjes dhe përmirësimit të kushteve të jetesës për këtë komunitet. Kemi përgatitur dhe shpërndarë materiale informuese, duke përfshirë broshura të shkruara në shkrimin braj dhe shkrim të zmadhuar, si dhe video sensibilizuese. Këto materiale janë dizajnuar për të siguruar që informacioni të jetë i arritshëm për personat e verbër, duke përdorur një gamë të gjerë mediesh. Për të thelluar ndikimin e fushatës sonë, kemi ofruar materialet e përgatitura për shoqatat e personave të verbër. Këto hapa janë ndërmarrë me synimin e qartë për të siguruar që të gjithë anëtarët e komunitetit, pavarësisht nga ndonjë ndryshim i mundshëm, të kenë mundësinë për të aksesuar dhe përfituar nga burimet dhe shërbimet e ofruara në fushën e informimit.

## **Trajnimet për gjithëpërfshirjen në edukimin fizik**

Organizuar nga Komiteti Paralimpik i Kosovës kanë filluar trajnimet me mësimdhënësit e edukatës fizike në shkollat e mesme dhe fillore të Kosovës në temën e gjithëpërfshirjes në edukimin fizik. Trajnimi që bazohet në librin me të njëjtin emër botuar vitin e kaluar nga Komiteti Paralimpik dhe me autor Ahmet Mahmutaj, gjatë vitit 2024 janë planifikuar mbajtja e dhjetëra trajnimeve në Komunitet e ndryshme të Kosovës, për të prezantuar punën me nxënësit me nevojë të veçanta në orën e edukatës fizike.

Trajnimet që janë dizajnuar për mësimdhënësit e edukatës fizike, në komuna po i ndjekin edhe asistentët për fëmijë me nevojë të veçanta, edukatorët dhe mësimdhënësit e ciklit të ultë, në mënyrë që të jenë mbështetja dhe personat e trajnuar që krijojnë një spektër të gjerë, sa më aktiv në punë me fëmijë.

Trajnerët e angazhuar janë Ahmet Mahmutaj, Enver Ulaj dhe Arbër Grabovci.

Baza e këtyre trajnimeve fillon me të dhënat që vijnë nga terreni sipas të cilave në shumë nga shkollat e Kosovës, nxënësit me aftësi të kufizuara nuk janë të përfshirë në procesin arsimor gjatë orëve të edukatës fizike, duke u lënë mënjanë apo duke u përjashtuar tërësisht nga procesi arsimor.

Mësimdhënësit e edukatës fizike, asnjëherë nuk kanë qenë më parë të trajnuar se si të përfshijnë personat e tillë në proces mësimor. Trajnimet përmbajnë udhëzime se si të ëprfshihen nxënësit në proces mësimor, si të modifikohen ambientet e punës për edukim fizik të personave me aftësi të kufizuara, si të modifikohen rregullat, mjetet dhe rekuizitet.

Dy komunitet e para në të cilat është mbajtur trajnimi janë komunitet e Malishevës dhe Klinës. Në komunitet e Klinës bazuar në kërkesa nga mësimdhënësit dhe DKA, janë mbajtur trajnime në dy grupe. Gjatë muajit maj dhe qershor trajnimet do vazhdojnë edhe në komuna tjera.

Trajnimet financohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ndërsa organizohen nga Komiteti Paralimpik i Kosovës.

## **U publikua antologjia e shkrimeve të krijuesve të verbër në Kosovë “Një zemër e mirë”**

### **FJALA DEL NGA SHPIRTI**

Fjala është një nga mjetet më të fuqishme që i është dhënë njerëzimit. Njerëzimi e ka përdorur atë si mjet, si armë dhe si material mbi të cilin kanë ndërtuar historinë dhe dijen duke lënë pas vetës trashëgiminë. Njerëzit e kanë përdorur për të shprehur veten e tyre, dëshirat dhe nevojat, kurse poetët e kanë përdorur si brumi me të cilin kanë shprehur ndjenjat dhe gjakimet, mbi të cilat kanë ndërtuar kryeveprat. Fjala, për personat e verbër, në shumë raste zëvendëson syrin dhe të parin dhe prandaj ka një vlerë të veçantë në të gjitha funksionet jetësore të tyre. Si e tillë fjala merr rolin e një shkopi mbi të cilin peshon dora e personit që nuk sheh.

Kur fjala del nga shpirti, atëherë ajo ka fuqinë që ta dridh edhe dorën edhe gjunjët apo zemrën e personit përballë që sheh. Kështu ajo arrin të depërtojë në thellësitë e shpirtit, aty ku as syri i njeriut që sheh nuk arrin dot. Në raste të tilla komunikimi artistik tejkalon rolin e artit, ai bëhet një urë njohje për shpirtin dhe është lidhje mes shqisores dhe ndjenjësores.

Këtë e përjeton njeriu kur lexon këtë libër që kemi në dorë.

Kur përgatitet një libër gjithmonë ka një pyetje se kujt i dedikohet dhe çka do të arrihet me të. Me këtë libër Shoqata e të verbërve të Kosovës synon që një publik të gjerë ta njoftojë mbi krijimtarinë e personave me dëmtim në të parë nga Kosova, që kush më shumë e kush më pak kanë marrë kurajën për të shkruar dhe shprehur botën e vet përmes letërsisë. Krijimet e paraqitura këtu janë botuar më parë në libra tjerë, por tash pjesë të këtyre librave i rikthehen lexuesit në një koleksion krijuesish që vijnë me moshë dhe përvoja të ndryshme, me apo pa synimin të vazhdojnë më tej rrugën e krijimtarisë letrare, të cilën disa prej tyre për shkaqe të ndryshme e kanë braktisur me kohë.

Libri përbëhet prej tri pjesëve. Në pjesën e parë janë prezantuar më zgjerimisht tre krijues që tashmë kanë publikuar veprat e tyre poetike. I pari është Gëzim Rexha me një publikim të një kohe shumë më të vjetër, që për fat të keq nuk është vazhduar më tej me botime tjera, pasi përmbledhja e parë ishte shumë premtuese. E dyta është Fjolla Muhaxhiri Agusholli, që është prezantuar mjaft mirë dhe me shumë ambicie në fushën e letërsisë në dy vjetët e kaluara. Vepra e saj në poezi dhe prozë në një kohë të shkurtër është vlerësuar, ka marrë çmime dhe është përfaqësuese në rrethet krijuese. Duke parë pasionin e saj krijues dhe përkushtimin, që tani e dimë se ajo do vazhdojë këtë rrugë dhe në vazhdim do të presim edhe libra tjerë. Krijuesi i tretë i prezantuar në këtë libër është Betim Bregovina, pothuaj një veteran i poezisë në komunitetin e personave të verbër. Librin e parë ai e ka botuar 20 vjet më parë dhe ai nuk ka reshtur së shkruari dhe botuari që atëherë, duke paralajmëruar se nga ai do të presim vepra të reja dhe forma të reja të të shprehuri, për të cilat ai gjithnjë gjen mbështetjen dhe donatorët që ia mundësojnë të shprehë ato që krijon.

Pjesa e dytë përfshin krijues që paraqitjet e tyre në publik i kanë pasur vetëm episodike dhe një pjesë e tyre i kanë ndarë kaheër rrugët me krijimtarinë. Por ka aty krijues që edhe të befasojnë me pjekurinë artistike apo me ndjenjën. Librat si ky mund të jenë stimulues për ta që të vijojnë edhe më tej dhe të mos largohen nga krijimtaria.

Në pjesën e tretë janë krijimet në prozë, që është më e varfër tek krijuesit e verbër në Kosovë. Pjesa më e madhe e përzgjedhur vjen nga romani “Trëndafili që nuk e vyshkën stuhinë” i autores Fjolla Muhaxhiri Agusholli, si dhe disa krijime tjera që plotësojnë një mozaik letrar të ndërtuar tërësisht mbi përvojat personale të njohjes dhe përballjes me jetën dhe botën.

Libri është botuar nga Shoqata e të verbërve të Kosovës me mbështetje nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me qëllim të promovimit të krijuesve që vijnë nga komuniteti i personave të verbër apo me shikim të dëmtuar. Ai prezanton 21 zëra që na kujtojnë se dëshira për artin e krijimit nuk ka ndalesa e as kufi, dhe se arti rrjedh nga shpirti dhe gjen mënyrën për të dalë në letër dhe për t’i komunikuar botës atë që ndjen shpirti edhe kur syri nuk e sheh.

## Aktivitetet e QBMK

QBMK Xheladiun Deda gjatë periudhës së fundit kam vazhduar aktivitetet dhe angazhimet e saj në shërbimet që ofron për nxënësit e verbër dhe në partneritet. Kështu ka vazhduar bashkëpunimi i mirë me SHVK në disa nga projektet që implementohen në bashkëpunim, ashtu si edhe me Ministrinë e arsimit dhe kulturës, Komitetin paralimpik të Kosovës etj.

Nga aktivitetet tjera shkurt që na ka ofruar qendra burimore veçojmë:

- QB ka ofruar anëtarët të vet për ekspertizë dhe ofrim të përvojës me pjesëmarrja në grupin punues për caktimin e lekturës shkollore për hartimin e listës së librave për lekturë si dhe angazhimi me ekspertizë me një anëtarë për ekipin vlerësues në kuadër të Autoritetit kombëtar të akreditimeve. Pesë sesione të angazhimi me fëmijë me nevoja të veçanta në SHFMU Tetë Marsi të Pejës në temën e gjithëpërfshirjes në sport dhe olimpiadat speciale
- Është marrë akreditimi nga MASHTI për gjashtë trajnime të akredituara të cilat QB mund t'i mbajnë në vitet në vazhdim nëpër Kosovë
- Është përgatitur një plan vjetor trajnimesh bashkë me SHVK dhe KPK për trajnime për gjithëpërfshirës dhe ka filluar implementimi i këtij plani
- Projekti japonez është në vijim, është përcjellë tenderi dhe ofertimit (është përfunduar ndërtimi i garazhës në parkingun e shkollës dhe kanë filluar punimet fizike për dhomën sensorike, kurse ofertomi për dhomën sensorike është ende në proces)
- Angazhim me MKRS lidhur me hulumtimin për monografinë e sportit për personat me aftësi të kufizuara ka vazhduar, libri është përfunduar dhe është publikuar.
- Angazhim në partneritet me SHVK, u publikua antologjia me krijimtarinë e autorëve të verbër në Kosovë
- Është bërë kërkesë drejtuar ARKEP për të kërkuar dy vetura për shkollën. Poashtu është ri adresuar kërkesa e mëparshme drejtuar zëvendës kryeministrit tashme edhe adresuar drejt Kuvendit të Kosovës poashtu për dy vetura.
- Pjesëmarrje në projektin “Drejt Malit” në skijim, aktiviteti njëjavor me nxënës, mësimdhënës dhe prindër në skijim në Brezovicë.
- Hartimi i një projekti për komunën e Prishtinës (trajnimi i mësimdhënësve të Prishtinës- gjithëpërfshirja në edukimin fizik) në bashkëpunim me Komitetin PARalimpik të Kosovës
- Hartimi i një projekti UNMIK-(trajnimi i mësimdhënësve të Prishtinës- gjithëpërfshirja në edukimin fizik) në bashkëpunim me Komitetin Paralimpik të Kosovës
- Bashkëpunim me bibliotekën e Pejës Azem Shkreli, Arti nëpër shkolla, vizitë dhe ligjëratë nga drejtoresha e bibliotekës me nxënësit e shkollës lidhur me librin.
- Pjesëmarrje në pritjen festive nga Ambasada Çeke në Prishtinë
- Pjesëmarrja në aktivitete Olimpiada paraspotrive Vushtrri 2024 me prezantim të nxënësve në disa disiplina sportive nga sportistët e klubit të Shkollës
- Mbështetje me udhëzime për QB Nëna Tereze për monografinë e 70 vjetorit të shkollës
- Nga komisioni mediko social janë marrë emrat për 6 fëmijë të moshave parshkollore dhe shkollore, të cilët duhet përcjellë më tej nëse marrin shërbime.

- Nga Fridom Sentifiks kemi marrë donacion 8 monitorë zmadhues për nxënësit në qender dhe inkluzion
- Vizitë nga nxënës të shkollës” Mihal Grameno” Fushë Kosovë dhe nga nxënësit nga shkolla Shkëndija nga Suhareka, vizitë shkollës dhe njohje me nxënësit
- Ribotimi i librit të tretë të QB, Orientimi dhe mobiliteti për nevojat e mësimdhënësve nëpër Kosovë dhe shërbimeve të mbështetjes
- Ribotim i broshurës “Zhvillimi i shërbimeve të mbështetjes”, prezantim i shkollës
- Shënimi i ditës së shkollës, aktivitet kulturore në qendër dhe aktivitet në natyrë
- Trajnime dyditor gjithpërfshirja në lëndën e edukimit fizik më mësimdhënësit e Malishevës (financuar nga KPK)
- Është përfunduar hulumtimi dhe është dorëzuar në botim monografia e sportit për personat me aftësi të kufizuara (mbështetur nga MKRS)
- Mbështetje për aplikim për SHVK tek MKRS për projektin lidhur me fëmijët dhe trashëgimia kulturore
- Mbështetje – bashkëpunim për shkollën e artit Pejë projekte me aktivitete me nxënës
- Mbështetje për SHNV Peja për aplikim lidhur me librat në braj
- Koordinimi me shkollat në Shkup dhe Tiranë për aktivitete të përbashkëta kulturore
- Përgatitja e materialeve për katalogun e MASHTI për trajnimet e akredituara në Kosovë
- Aktiviteti promovues i xhudos në bashkëpunim ekipi sportive i Shkollës me Klubin e Xhudos Peja
- QB ka pasur një prani të konsiderueshme në media: Lajme në mediat Zëri, Telegrafi, gazeta Olle, faqja zyrtare e Komitetit Paralimpik të Kosovës, Artikuj ne dy vazhdime ne revistën Koha Javore, Reportazh nga gazeta/tv Neutral dhe dhjetëra postime në rrjetet sociale

## **Vizita historike e Presidentit të Komitetit paralimpik ndërkombëtar Andrew Parsons**

Në periudhën prej 16 deri më 19 mars 2024, Kosova u nderua me vizitën e Presidentit të Komitetit Paralimpik Ndërkombëtar, Andrew Parsons. Vizita e Presidentit Parsons në Kosovë shënoi një moment të rëndësishëm për promovimin dhe zhvillimin e sportit paralimpik në vend, si dhe për thellimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në këtë fushë.

Në fillim të vizitës së tij, Presidenti Parsons u prit me nderime të veçanta nga Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, një përshëndetje që theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe përkrahjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në sport. Gjatë kohës së qëndrimit të tij, Presidenti Parsons pati takime të rëndësishme me personalitete të larta të qeverisë dhe të sportit në Kosovë, duke përfshirë Kryeministrin Albin Kurti dhe Krye parlamentarën Glauk Konjufca. Këto takime ishin rrethuar me diskutime të hollësishme për sfidat dhe mundësitë në promovimin e sportit paralimpik në Kosovë dhe për rrugën përpara në garantimin e një fushate më të suksesshme dhe më të përfshirëse për sportistët me aftësi të kufizuara.

Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, Presidenti Parsons mori pjesë në një gamë të gjerë aktiviteteve, duke filluar nga një takim me Bordin e Komitetit Paralimpik të Kosovës, ku u diskutua për përparimet dhe sfidat në fushën e sportit paralimpik në vend. Në vazhdim, një moment i veçantë u shënu në Sallën e Madhe të Pallatit të Rinisë, ku u organizuan disa disiplina sportive, duke përfshirë goal ball të verbër, boca, dhe judo. Kjo aktivitet jo vetëm përforcoi ndërgjegjësimin për rëndësinë e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sport, por gjithashtu u bë një shfaqje e qartë e potencialit të tyre në këtë fushë.

Përveç kësaj, Presidenti Parsons mori pjesë në një intervistë televizive të rëndësishme, ku u diskutua për sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e sportit paralimpik në Kosovë. Në këtë intervistë, Presidenti Parsons dhe Njomza Emiri, Presidentja e Komitetit Paralimpik të Kosovës, shpërndanë pikëpamjet e tyre dhe vizionin për të ardhmen e sportit paralimpik në vend.

Vizita e Presidentit Parsons u përshëndet gjithashtu me një darkë zyrtare për nder të tij, e cila ishte e mbushur me përfaqësues të ambasadave të ndryshme, përfaqësues të qeverisë dhe institucioneve lokale, si dhe personalitete të sportit. Kjo darkë jo vetëm shënoi një rast të veçantë për të festuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të shkëmbyer përvoja në fushën e sportit paralimpik, por gjithashtu krijoi një platformë për të thelluar marrëdhëniet e bashkëpunimit në të ardhmen.

Në përfundim të vizitës, u organizua një konferencë për media, ku pjesëmarrja e mediave vendore solli një rast për të shpërndarë mesazhe dhe informacione të rëndësishme lidhur me vizionin dhe përpjekjet për zhvillimin e sportit paralimpik në Kosovë.

Vizita e Presidentit Andrew Parsons në Kosovë ishte një hap i rëndësishëm drejt përparimit të sportit paralimpik në vend, si dhe një rast për të thelluar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të promovuar përfshirjen dhe barazinë në fushën e sportit për të gjithë.



Për librin “Sporti për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë”, monografi e hartuar nga autorët Ahmet Mahmutaj dhe Enver Ulaj. Recension nga Besim Hasani, Ish kryetar i Komitetit Olimpik të Kosovës

### **Historik gjithëpërfshirës i zhvillimit të sporteve te personat me aftësi të kufizuara në Kosovë**

Për t’u pasqyruar në mënyrë reale por edhe të kuptueshme për të gjithë lexuesit vendorë dhe ndërkombëtarë, zhvillimi i sportit në Kosovë, nga Lufta e Dytë Botërore e deri sot, do të duhej të ndahej në tri periudha:

- pas Luftës së Dytë Botërore (1945-1989),
- pas suprimimit me dhunë të autonomisë së Kosovës (1989-1999) dhe
- pas largimit të regjimit serb nga Kosova (1999- deri sot).

Këtë ndarje në vija të trasha e bëjnë edhe dy autorët e librit-monografisë “Sportet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë”

Monografia “Sportet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë” e autorëve Ahmet Mahmutaj dhe Enver Ulaj e ka sjellë këtë historik duke e ndarë në periudhat e lartcekura dhe duke e pasqyruar tërë spektrin e vështirësive me të cilat janë ballafaquar personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë pas kurajën të merren me sport. Dy autorët, me të cilët njihem për një kohë të gjatë, përkundër mungesës së materialeve arkivore, ia kanë dalë të shpalosin vijimësinë kronologjike të zhvillimit të sportit dhe lexuesi ndjehet i plotësuar duke lundruar në kohë dhe duke përjetuar e ndjerë zhvillimin në ngritje të sportit në mesin e pjesës më të marginalizuar të shoqërisë kosovare.

Në periudhën e pasluftës së dytë botërore, hapat e parë në sportin rekreativ bëhen nga personat e verbër dhe shurdhmemec. Sa për sqarim, edhe RSFJ ka përcjellë hapat modest të zhvillimit të sportit për personat me aftësi të kufizuara në nivelin botëror, ndërsa këto aktivitete në Kosovë zhvillohen në mënyrë sporadike dhe me një vonesë të theksuar. Sidoqoftë, autorët ndriçojnë këtë periudhë me institucionet e përfshira dhe individët kontribut dhënës, duke u ndalur në momentet më interesante dhe kyçe, që kanë qenë hapat fillestarë, dhe ja tash, kjo monografi sheh dritën, kur kanë mbetur vetëm pak ditë para pjesëmarrjes së para sportistëve të Kosovës në Lojërat Paralimpike Parisi 2024, spektaklin më të madh sportiv e kulturor në tërë planetin tonë.

Monografia “Sportet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë” e autorëve Ahmet Mahmutaj dhe Enver Ulaj e ka sjellë këtë histori të vështirësive me të cilat është përballur organizimi i sportit tek personat me aftësi të kufizuara, të punës së madhe që është dashur, hapave të vegjël që njëri pas tjetrit kanë sjellë deri në ditët e sotme, kur sportistë me aftësi të kufizuara marrin pjesë në evente të rëndësishme ndërkombëtare dhe në vitin 2024 presim pjesëmarrjen e parë në lojërat paralimpike në Paris, që është skena më e madhe e prezantimit të sportistëve nga e gjithë bota.

Libri sjellë pjesë dhe kapituj të afërt dhe të largët të udhëtimit nga nismat e para në Kosovë deri tek lojërat olimpike, duke u ndalur në momentet më interesante çastet kyçe, që kanë qenë hapat domethënës për sportet e veçanta dhe sipas kategorive të dëmtimeve dhe federatave përkatëse. Autorët i kanë dhënë rëndësi sidomos fillimeve në secilin nga sportet, duke u ndalur te nismëtarët dhe

themeltarët, ata që sot meritojnë respektin që kanë qenë të parët që hapur rrugë të reja, në të cilat sot arrijnë sukseset dhe derdhin djersën e tyre qindra sportistë.

Materiali i monografisë është sistemuar në dy pjesë, që kuptueshëm paraqesin dy faza të zhvillimit të tërësishëm të Kosovës. Faza e parë që përfshin iniciativat e para sportive tek personat me aftësi të kufizuara në ish Jugosllavi, që na njeh me fillimet e organizimit nga lidhjet e sporteve për personat me invaliditet, siç quheshin atëherë, krijimin e klubeve dhe garave të para deri në nivel të federatës, ku përfshiheshin sportistët kosovarë. Me aq sa kanë mundur të gjejnë burime nga ajo kohë, autorët kanë paraqitur angazhimet dhe arritjet e personave të verbër dhe atyre të shurdhër, që fillojnë nga gjysma e dytë e shekullit apo periudha pas Luftës së Dytë Botërore e deri në të 90-at.

Periudha e suprimimit të autonomisë, e cila në fushën e sportit u manifestua me privim nga e drejta për t'u marrë me sport, mbyllja e palestave sportive të hapura dhe të mbyllura, institucionet sportive, klube e lidhje/federata ku gravitonin sportistët dhe parasportistët u bë, jo vetëm i pamundshëm por edhe me rreziqe reale për maltretime, rrahje, burgosje, madje edhe likuidime e vrasje barbare.

Pas mobilizimit të shoqërisë kosovare për qeverisje vetanake të institucioneve duke përfshi edhe sportin, u themeluan klubet e pavarura nga sistemi serbojugosllav, përfaqësuesit e klubeve formuan Federatat sportive dhe në majin e vitit 1992, nga përfaqësuesit e Federatave Olimpikë u formua Komiteti Olimpik i Kosovës, ndërsa nga Lidhjet sportive komunale u formua Federata e Sporteve të Kosovës për të zhvilluar aktivitete sportive deri edhe kampionate, e aty këtu, në mënyrë sporadike, hasim edhe personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në aktivitetet e federatave olimpikë, siç ishte vrapimi për Ditën Olimpikë i organizuar nga KOK.

Periudha e tretë, ajo e pas çlirimit nga regjimi serb dhe instalimin e UNMIK-ut, Shoqatat për personat me aftësi të kufizuara, OJQ vendore e ndërkombëtare u mobilizuan të përfshijnë sa më shume persona me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme.

Zhvillimi i sporteve në Kosovë në periudhën e pasluftës në Kosovë ka kaluar dy faza të rëndësishme në zhvillimin. Të parën, atë të injorimit total nga organizatat sportive ndërkombëtare, derisa gradualisht pas shpalljes së pavarësisë u deshën disa vite, që të fillojnë, një nga një, të pranohen federatat sportive në organizmat ndërkombëtarë të sportit, duke krijuar mundësitë për sportistët tonë që të realizojnë ëndrrën e tyre për përfaqësuar Kosovën në ngjarje sportive dhe për të synuar të prezantojnë arritjet e tyre në arenat ndërkombëtare të sporteve.

Këto dy faza ka kaluar edhe zhvillimi i sporteve për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, por duke veçuar se në këtë kategori të shoqërisë për një kohë të gjatë ka munguar shumë edhe mbështetja nga institucionet.

Autorët Mahmutaj dhe Ulaj me sukses ndriçojnë këtë periudhë të zhvillimit të sportit tek personat me aftësitë kufizuara, histori kjo e sukseseve dhe arritjeve, me shumë përpjekje e pak mbështetje, por që kanë lënë gjurmë dhe trashëgimi.

Shumicën e këtyre parasportistëve, trajnerët e tyre, asistentët, referët dhe drejtuesit e tyre kam pas rastin t'i njoh personalisht, pasi isha ne krye të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe organizatat dhe parasportitët, atëbotë, si ombrellë kishin KOK-un deri në themelimin e KPK në vitin 2012, dhe me ta të ndajmë sukseset brenda dhe jashtë vendit.

Sot, Lëvizja Paralimpike e Kosovës është e strukturuar sipas kriterëve ndërkombëtare, bazuar në statute të harmonizuara me statutet e federatave përkatëse ndërkombëtare të miratuara nga kuvendet përkatëse, me organe të zgjedhura në mënyre demokratike. Ka mbi 50 klube, mbi 10 Federata, mbi 750 drejtues, staf, asistentë, trajnerë e referë dhe, mbase, mbi 1000 persona me aftësi të kufizuara, që në ndonjë formë janë të përfshirë në sport.

Pjesë e dytë, ajo nga çlirimi i Kosovës e deri në ditët e sotme, është shumë më e plotë dhe më komplekse. Ajo tregon vështirësitë dhe sfidat që ka pasur rifillimi i organizimit të pasluftës në kohën e emergjencës dhe mbështetja që kanë ofruar organizata dhe individë të veçantë.

Monografia paraqet edhe arritjet e shumë individualiteteve që kanë me veprën dhe arritjet e tyre të inspirojnë, histori të sukseseve të arritura me vështirësi, në shumë raste me shumë pak apo aspak mbështetje, por që kanë arritur të lënë gjurmët e veta në këto sporte në Kosovë dhe jashtë saj. Çmime dhe medalje, fitore dhe arritje që sportistëve iu kanë dhënë sadsifaksion, por asnjëherë shpërblime nga shteti. Në cilësinë e presidentit të Komitetit Olimpik të Kosovës, unë i kam parë këto përpjekje, në aktivitet që janë organizuar fillimisht nga KOK, në përpjekje për të mbështetur sportistët me aftësi të kufizuara deri në themelimin e organizatave dhe strukturave të tyre të organizimit, që sot drejtojnë sportin tek personat me aftësi të kufizuara në Kosovë.

Përfundimisht, monografia "Sportet për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë" është një historik gjithëpërfshirës i zhvillimit të sporteve tek personat me aftësi të kufizuara në Kosovë. Është libri i parë i këtij lloji në Kosovë dhe është një kontribut i çmuar në dëshmimin e historisë së zhvillimit të sporteve tek personat me aftësi të kufizuara. Autorët kanë bërë një punë të madhe për të mbledhur gjithë dëshmitë dhe faktet e disponueshme, në mënyrë që ajo të dëshmohet dhe mbetet për të ardhmen si një dëshmi për të gjithë ata që dëshirojnë të njohin të kaluarën dhe mënyrën se si është ardhur deri në ditët e sotme.

Rrëfimet dhe historia e sportistëve me aftësi të kufizuara janë rrëfime që na frymëzojnë të gjithë në neve për të tejkaluar pa u ankuar të gjitha sfidat që kemi në rrugën drejt arritjes së suksesit.

Prishtinë, mars 2024

## **Kronikë lajmesh nga sporti vendor dhe ndërkombëtar**

### **Supergol i Krasniqit në fitoren e Stromsgodsetit**

Mesfushori që ka përfaqësuar grupmoshat e reja të Kosovës, Kreshnik Krasniqi, ka shënuar supergol të mërkurën mbrëma për Stromsgodsetin në 1/16 e finales së Kupës së Norvegjis.

Krasniqi realizoi në minutën e 25-të me gjuajtje shumë të fuqishme në minutën e 25-të, në fitoren 4:0 të skuadrës së tij ndaj Kristiansundit.

Ai luajti deri në minutën e 65-të në kualifikimin tutje të ekipit të elitës norvegjeze.

Të mërkurën në avancimin tutje të Lillestromit në Kupë ka kontribuar edhe Ylldren Ibrahimaj, që ka asistuar në golin për 4:2. Lillestromi befaso në udhëtim skuadrën e suksesshme, Bodo/Glimt.

### **Shkëndija, Struga e Shkupi vazhdojnë garën e fortë për titull**

Shkëndija e Tetovës, Struga dhe Shkupi kanë vazhduar garën e fortë për titull kampioni në elitën e futbollit të Maqedonisë së Veriut.

Por ata që përfituan më së shumti nga xhiroja e 30-të që u zhvillua të mërkurën, ishin “kuqezinjët” e Tetovës.

Shkëndija mposhti 3:2 në shtëpi Brera Strumicën dhe ka dalë në krye të tabelës me pikë të njëjta me Strugën e Shkupin, nga 58 gjithsej.

Struga pësoi humbje në udhëtim te Tikveshi 3:2, kurse Shkupi u mposht si mysafir i skuadrës tjetër shqiptare, Gostivari, 2:0.

Të mërkurën nga skuadrat shqiptare, fitore realizoi edhe Voska Sport, që mposhti në udhëtim Makedonija GP-në, 2:0.

Gostivari është në mesin e tabelës me 40 pikë, kurse Voska ka 37 pikë në vendin e nëntë, pesë më shumë se Vardari që aktualisht është në zonën e plejautit.

### **Ylli luan për finale, Peja për të vazhduar serinë**

Te Golden Eagle Ylli e te Peja kanë synimet e tyre, ndërsa pajtohen që ndeshja e së mërkurës mbrëma do të jetë “luftë sportive”.

Ylli e Peja takohen në palestrën “13 Qershori” në Suharekë, në ndeshjen e katërt të serisë gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në basketboll. Ndeshja fillon në orën 19:00.

Ylli udhëheq 2:1 dhe me fitore kualifikohet në finale, ku tashmë pret Trepça. Ndërkohë Peja me fitore siguron ndeshjen e pestë dhe vendimtare, që do të zhvillohej në “Karagaçi”.

Peja e kishte përparësinë e terrenit vendas në këtë seri gjysmëfinale, por tashmë përparësia ka kaluar te Ylli.

Ylli fillimisht kishte fituar në Pejë me shifrat 87:84. Më pas kishte fituar edhe në Suharekë, 92:86.

Ndeshjen e tretë Peja e organizoi në Gjakovë, ku luajti pa praninë e shikuesve. Fitoi të shtunën me rezultat 98:86 dhe kështu u kthye në lojë.

Kapiteni i Yllit, Gëzim Morina, është optimist, por po ashtu pranon nivelin e Pejës.

“Nesër na pret një luftë e madhe. Mendoj që të dy skuadrat do të japin gjithçka nga vetja dhe do të synojnë fitoren. Peja ka ekip të mirë. Këtë edhe e tregoi në ndeshjen e fundit. Kemi analizuar gabimet që i kishim në ndeshjen e kaluar. Nesër me angazhim maksimal nga të gjithë lojtarët, presim që të sigurojmë fitoren dhe kalimin në finale”, ka thënë Morina të martën për KOHËN.

Ai është prej lojtarëve me kontributin më të madh tek Ylli. Skuadra suharekase pret edhe përkrahjen e shikuesve për ta kaluar me sukses gjysmëfinalen.

Kampionia në fuqi, Peja, dëshpëroi me rezultat, por edhe me paraqitje, në dy takimet e para gjysmëfinale. Por dha shenja të përmirësimit të madh në ndeshjen në Gjakovë. Dhe momenti pozitiv synohet të shfrytëzohet edhe të mërkurën.

“Po shikojmë para drejt ndeshjes së mërkurës. Do të jetë një tjetër ndeshje nokaut”, ka thënë trajneri i Pejës, Rami Hadar. Ai vjet e udhëhoqi Pejën drejt titullin të kampionit. Por skuadra pejane ka vuajtur për stabilitet këtë edicion.

“Me Yllin kemi luajtur tetë apo nëntë herë këtë edicion. Skuadrat njihen shkëlqyeshëm me njëra-tjetrën. Duhet të bëjmë më të mirën për të luajtur edhe më mirë. Por do të jetë luftë sportive”, ka shtuar Hadar.

Peja në gjysmëfinale u kualifikua direkt, si e dyta në stinorin e rregullt. Ylli në çerekfinale e kaloi Bashkimin, me rezultatin 2:0.

Në gjysmëfinalen tjetër Trepça ka dominuar plotësisht ndaj Sigal Prishtinës. Ka fituar tri ndeshjet e para dhe tashmë është në pritje të kundërshtarit të finales.

### **Pesë xhiro të zjarra në garën për titull në kampionat kosovar të futbollit**

Te Ballkani dhe te Llapi tregohen të matur lidhur me atë se cili ekip është favorit për të dalë kampion në fund. Por më konkret në përgjigje është trajneri i futbollit, Gani Sejdiu.

Trajneri mitrovicas thotë se Llapi e Drita kanë orar më të favorshëm se lideri dhe kampioni në fuqi, Ballkani.

Xhiron e parafundit, sipas Sejdiut, mund të jetë përcaktues për kampionin e ri të Kosovës në futboll. Në xhiron e 35-të Llapi e pret Ballkanin, kurse Drita luan derbin e qytetit ndaj Gjilanit.

Pesë xhiro para fundit, Ballkani është lider me 63 pikë. Llapi është i dyti me 61 pikë, kurse Drita zë vendin e tretë me 59 pikë.

Ndeshjet e pesë xhirove të fundit të edicionit 2023/2024 do të luhen ditëve të njëjta dhe në termin të njëjtë.

“Nëse i referohemi kësaj faze të mbetur, Llapi dhe Drita mund të themi se kanë një orar pak më të favorshëm se Ballkani. Por kjo nuk është përcaktuese, sepse mund të ketë befasia. Por përcaktuese mund të jetë xhiron e 35-të, nëse deri atëherë ekipet nuk gabojnë. Do të jetë luftë e paparashikuar deri në fund, sidomos mes Llapit e Ballkanit, pasi luajnë takimin vendimtar mes vete. Drita është aty me një orar më të favorshëm dhe do të jetë deri në fund në garë për titull”, ka thënë Sejdiu të mërkurën për KOHËN. Drita në fundjavën e shkuar u ndal në barazim 1:1 nga Dukagjini në Klinë, kurse Ballkani dhe Llapi nuk gabuan. Shënuan fitore me rezultat 2:0. Ballkani mposhti në udhëtim Gjilanin, kurse Llapi i fitoi pikët e plota ndaj Prishtinës në kryeqytet.

Sulmuesi i Ballkanit, Almir Kryeziu thotë se do ta japin maksimumin deri në fund të kampionatit.

“Fazën finale shpresojmë ta vazhdojmë me këtë formë të mirë si në ndeshjet e fundit. Duhet ta japim maksimumin në çdo ndeshje. E dimë edhe ne që këto ndeshjet e fundit janë shumë të rëndësishme dhe besoj që me këtë ekip, me këtë formë, do ta mbrojmë titullin kampion”, ka thënë Kryeziu.

Titullin e kërkon edhe Llapi i udhëhequr nga trajneri Tahir Batatina. Batatina ka bindjen se Llapi do të festojë në fund.

“Nëse e shohim në letër orarin, mendoj se na favorizon, pasi i presim dy rivalë të fortë si vendas. Por kemi edhe dy ndeshje të vështira me klubet që luftojnë për mbijetesë, Feronikeli 74 dhe Gjilani. Të dyja këto ekipe kërkojnë t’i ikin barazhit. Janë dy ndeshje që duhet të bëjmë maksimumin. Por fillimisht jemi duke menduar vetëm për ndeshjen kundër Feronikelit 74. Mund të them se të gjitha ndeshjet janë finale për ne. Dhe, në të gjitha këto ndeshje finale ne duhet ta japim maksimumin. Besoj se kemi skuadër të mirë, duhet ta japim më të mirën edhe pse ky është futboll dhe nuk i dihet. Ne kemi arritur të jemi në zonën që dërgon në Evropë. Kjo është shumë e rëndësishme, por më e rëndësishme është që në këtë vit ta japim maksimumin për të dalë në pozitën e parë”, ka theksuar Batatina.

### **Drita dënohet me katër ndeshje pa shikues dhe 1500 euro gjobë**

Situatë për Dritën e Gjilanit sa shkon e rëndohet. Të martën Komisioni Disiplinor dhe Etikës i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar klubin gjilanas me zhvillimin e katër ndeshjeve në terren të vet pa praninë e shikuesve dhe me gjobë prej 1500 euro.

Ky dënim Dritës i është shqiptuar për lëshim në organizimin e ndeshjes gjysmëfinale të Kupës ndaj Prishtinës. Ajo ndeshje ishte zhvilluar më 24 prill në stadiumin me bari sintetik në Gjilan.

“Pas përfundimit të ndeshjes, tifozët e Dritës manifestuan sjellje të ashpra, josportive, e të cilat dëmtojnë autoritetin sportiv të futbollit. Sjelljet e tyre janë manifestuar me gjuajtje të gjësendeve të palejuara në drejtim të lojtarëve të Prishtinës, përafërsisht 25 shishe plastike. Tifozët e Dritës kalojnë rrethojat, duke depërtuar në fushë dhe duke u konfrontuar drejtpërdrejt fizikisht me zyrtarët e klubit Drita”, shkruan në arsyetim të vendimit.

Sipas njoftimit të FFK-së “vendimi është i nevojshëm për të mbrojtur integritetin dhe imazhin e sportit dhe për të zbatuar rregullat dhe normat e përgjithshme të sjelljes sportive konform akteve normative të federatës”.

Pas asaj ndeshjeje dhe konfliktit në stadium, drejtori sportiv i Dritës, Valon Zymberi, i shoqëruar me persona të tjerë të klubit dhe të afërt me të, kishin sulmuar në lokalën e tij udhëheqësin e tifozëve “Intelektualët”. Zymberi ishte ndalur për 48 orë dhe tani i është shqiptuar masë më e lehtë nga organet e drejtësisë. Drita i ka dalë në mbrojtje Zymberit, derisa ka dënuar dhunën. Ai vazhdon ta mbajë postin e drejtorit.

Drita u eliminua nga Kupa dhe bëri hap të madh prapa në garën për titull. Me dënimin e ri gjasat e Dritës për të vazhduar garën për titull zvogëlohen edhe më shumë. Deri në fund të kampionatit Drita nuk do ta ketë përkrahjen e shikuesve në ndeshjet si vendase.

### **Edon Zhegrova po lufton me Mbappen për çmimin e sezonit në ligën franceze**

Futbollisti i Kombëtares së Kosovës, Edon Zhegrova do të “luftojë” me yje për ta fituar çmimin si “lojtari i sezonit” në Ligue 1 të Francës

Mbrëmë faqja zyrtare publikoi listën e lojtarëve që janë duke synuar çmimin e më të mirit në fund të sezonit dhe emri i lojtarit kosovar figuron aty, shkruan Indeksonline

Është pikërisht Edon Zhegrova ai që së bashku me Kylian Mbappen, Ousmane Dembele, Pierre-Emerick Aubameyang dhe Lees-Melou që do të “luftojnë” kokë më kokë për çmimin e më të mirit.

Edon Zhegrova gjatë këtij sezoni në Ligue 1 ka zhvilluar 30 ndeshje, ka shënuar pesë gola dhe ka bërë pesë asiste./Indeksonline.

### **De Rossi për suksesin e Leverkusenit: Alonso është trajneri më i mirë**

Roma ka pritur në shtëpi skuadrën e Bayer Leverkusen, sfidë kjo e vlefshme për gjysmëfinalen e parë të Europa League, një ndeshje ku italianët nuk arritën synimin e duhur përballë kampionëve të Bundesligës. Ndeshja u dominua në tërësi nga Leverkusen që fitoi me rezultatin dy me zero.

Në lidhje me këtë përballje para ndeshjes kishte folur në konferencën për shtyp Daniele De Rossi, timonieri i verdhë kuqve kishte theksuar se pavarësisht se gjermanët janë të pamposhtur në këtë sezon sërish ata do të tentojnë fatin e tyre. Ndër të tjera nënvizoi se Xavi Alonso është një nga trajnerët më të mirë në botë.

“A i frikësoheni Bayer? Ka gjithçka për t’u frikësuar. Mënyra se si luajnë, ata kanë një seri të gjatë rezultatesh. Unë e respektoj shumë trajnerin e tyre, ata meritojnë respekt pasi janë të pamposhtur edhe pse shpesh luajnë prapa, por kanë qenë të fortë dhe kanë një këmbëngulje deri në minutat e fundit për të shënuar. Të pamposhtur? Nuk mendoj se është pengesë, ka skuadra që i kanë vënë në vështirësi. Fati është për ata që luajnë kazino dhe ne do të tentojmë të fitojmë në këtë përballje. Ka diçka të madhe në atë ekip. Ata kanë një trajner të fortë, ndoshta më të mirin në botë, lojtarë të shkëlqyer dhe ata luajnë futboll spektakolar”, ka theksuar timonieri i italianëve.

Megjithatë ndeshja e kthimit do të jetë shumë e vështirë për ekipin e Romës.

### **Pas ndeshjeve të para Dortmund në epërsi ndaj PSG-së**

Skuadra e Borussia Dortmund e ka përmbyllur ndeshjen e parë me golin e epërsisë ndaj Paris Saint-Germian në gjysmëfinalen e parë të UEFA Champions League.

Golin për 1:0 e shënoi sulmuesi gjerman, Fullkrug në minutën e 36’të, shkruan. Fullkrug shënoi një gol tejet të bukur pas një asisti fantastik nga mbrojtësi Schlotterbeck.

### **Spektakel në “Allianz Arena”, Bayern Munich dhe Real Madrid ndajnë pikët**

Në gjysmëfinaljen tjetër të Ligës së Kampionëve dy ekipet e mëdha kanë ndarë pikët. Ndeshja e dy ekipeve që kanë shumë trofe evropiane, i kënaqi të gjithë shikuesit me një lojë të mirë dhe me katër gola të shënuara. Ndeshja tjetër e kthimit në Madrid do të jetë poashtu një kënaqësi për gjithë adhuruesit e futbollit dhe Ligës evropiane së kampionëve.